



## DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05 - 13

Podujevë,

14/01/2021

Bazuar në nenin 20 pika 1, të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, i datës 29/08/2011, neni 5, pika d e Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, të datës 21/05/2008 dhe Udhëzimit Administrativ i MASHT-it për detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, nr. 151/2020, të datës 22/12/2020, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Podujevës, shpall:

## KONKURS

Për drejtorë dhe zëvendës drejtorë në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Pozita
1	Gjimnazi " Aleksandër Xhuvani "	Podujevë	drejtor
2	Gjimnazi " Aleksandër Xhuvani "	Podujevë	zëvendës drejtor
3	SHMLE " Isa Boletini "	Podujevë	drejtor
4	SHMLE " Isa Boletini "	Podujevë	zëvendës drejtor
5	SHMLT " Fan S. Noli "	Podujevë	drejtor
6	SHMLT " Fan S. Noli "	Podujevë	zëvendës drejtor
7	SHFMU " Naim Frashëri "	Podujevë	drejtor
8	SHFMU " Naim Frashëri "	Podujevë	zëvendës drejtor
9	SHFMU " Dr.Ibrahim Rugova "	Podujevë	drejtor
10	SHFMU " Dr.Ibrahim Rugova "	Podujevë	zëvendës drejtor
11	SHFMU " Shaban Shala "	Podujevë	drejtor
12	SHFMU " Xheladin Rekaliu "	Podujevë	drejtor
13	SHFMU " Zenel Hajdini "	Lupç i Poshtëm	drejtor
14	SHFMU " Afrimi e Fahriu "	Lluzhan	drejtor
15	SHFMU " Rilindja "	Herticë	drejtor
16	SHFMU " Musli Dumoshi "	Dumosh	drejtor
17	SHFMU " Naum Veqilharxhi "	Llapashticë e Epërme	drejtor
18	SHFMU " Nuhi Gashi "	Bradash	drejtor
19	SHFMU " Sami Frashëri "	Zhiti	drejtor
20	SHFMU " Luigj Gurakuqi "	Batllavë	drejtor
21	SHFMU " Lasgush Poradeci "	Dumnicë	drejtor
22	SHFMU " Shefki Kuleta "	Tërrenavë	drejtor
23	SHFMU " Kadri Kadriu "	Llaushë	drejtor
24	SHFMU " Jahë Hasani "	Bërvenik	drejtor
25	SHFMU " Sheqë Mirofci "	Shtedim	drejtor
26	SHFMU " Shefki Latifi "	Pollatë	drejtor
27	SHFMU " Dituria "	Llapashticë e Poshtme	drejtor

28	SHFMU " Kongresi i Manastirit "	Gllamnik	drejtor
29	SHFMU " Jetullah Gashi "	Dobërdol	drejtor
30	SHFMU " Eqrem Çabej "	Buricë	drejtor
31	SHFMU " Ilir Konushefci "	Llugë	drejtor
32	SHFMU " Hyzriu e Samiu "	Letanc	drejtor
33	SHFMU " Elfir Behrami "	Metehi	drejtor
34	SHFMU " Pavarësia "	Sibofc	drejtor
35	SHFMU " Enver Maloku "	Podujevë	drejtor
36	SHFMU " Dëshmorët e Kombit "	Podujevë	drejtor
37	Çerdhja "Armela"	Podujevë	drejtor
38	SHFMU " Zahir Pajaziti "	Orllan	drejtor
39	SHFMU " Ali Hadri "	Obrançë	drejtor
40	SHFMU " Ali Ajeti "	Sfeçël	drejtor
41	SHFMU " Hasan Ramadani "	Shajkofc	drejtor
42	SHFMU " Jetullah Islami "	Dyz	drejtor

**Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:**

1. Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendet e punës drejtor dhe zëvendës drejtor duhet t'i plotësojnë këto kushte:
  - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
  - 1.2. Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi:
    - Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimi 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
    - Master arsimor (kualifikimi prej 300 ECTS, 5 vite të shkollimit universitar);
    - Fakulteti katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, 4 vite të shkollimit universitar);
    - Bachelor katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, 4 vite të shkollimit universitar).
2. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve, ose të jenë në procedurë të licencimit (për këtë të ofrojnë dëshmi nga MASH).
3. Të kenë të përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të aprovuar nga MASHT, sipas rekomandimeve nga KSHLM;
4. Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master në udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve.
5. Të kenë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
  1. Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për arsimin e mesëm të lartë;
  2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët në niveleve tjera;
  3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendës drejtor
6. Të posedojnë këto dokumente:

- 6.1. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës (secili konkurrues dorëzon **kopjen e vërtetuar-noterizuar të diplomës Bachelor/Master**).
  - Në arsimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë (gjimnaze) duhet të jetë profili arsimor në bazë të normativit profesional për arsimin e përgjithshëm;
  - Për shkollat profesionale, kandidati/ja duhet të jetë i profilit përkatës për institucionin edukativo-arsimo ku konkurren, në bazë të normativit për arsimin profesional.
- 6.2. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- 6.3. Dëshminë se nuk është nën hetime dhe nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- 6.4. Dëshmi për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
- 6.5. Kandidati/ja për drejtor dhe zëvendësdrejtor nuk mund të jetë në funksion udhëheqës politik gjatë tri viteve para aplikimit.
- 6.6. Certifikatën e lindjes;
- 6.7. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID)

#### **6.8. Portfolio profesionale duhet të përmbajë:**

1. Biografinë e shkurtër të kandidatit.
2. **Konceptin e Planit Zhvillimor** të institucionit edukativo-arsimor, bazuar në pesë fushat e cilësisë së performancës së shkollës ( 5-10 faqe). Koncepti duhet të ketë **5–10** faqe tekst (minimum një faqe për një fushë të cilësisë) me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12, arial). **Koncepti** i PZH dorëzohet si pjesë e portofoljos po ashtu është pjesë përbërëse e intervistës që realizohet nga komisioni përzgjedhës. *(Për të marrë një kopje të Planit Zhvillimor aktual në institucionet e lartëcekura edukativo-arsimore, kandidati duhet t'i drejtohet drejtorit të shkollës ose personit të autorizuar nga KDSH i atij institucioni).*
3. Certifikatat që dëshmojnë përfundimin e programeve të zhvillimit profesional në fushën e administrimit, menaxhimit dhe udhëheqjes, si dhe dëshmi tjera që elaborojnë përfundimin dhe realizimin e pjesëve të programit dhe demonstrojnë shkathtësitë e fituara.
4. Certifikatat që dëshmojnë përfundimin e suksesshëm të programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve si dëshmi tjera rreth realizimit të atyre programeve.
5. Letër motivuese për pozitën që aplikon.
6. Dëshmi për aktivitetet tjera në proceset e zhvillimit të arsimit (zhvillimi i kurrikulave, udhëheqja e programeve të zhvillimit profesional, pjesëmarrja dhe kontributi në konferenca, etj).
7. Dëshmi nga përvoja paraprake në menaxhim (shembuj të projekteve, shembuj të shkrimeve nga fusha e menaxhimit, shembuj të planeve për zhvillimin e institucionit edukativo-arsimor që janë zhvilluar dhe/apo implementuar me udhëheqjen apo kontributin tuaj konkret).
8. Dëshmi nga përvoja paraprake në mësimdhënie (shembuj të planeve të mësimin, shembuj të projekteve, kopje të punimeve, mirënjohje, etj).
9. Letër referencë me përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake nga një institucion publik-kredibil, drejtpërdrejtë e lidhur me punën e kandidatit dhe për konkursin

përkatës (si Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DKA, këshilli drejtues i institucionit edukativo-arsimor, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngushtë në programe dhe projekte të ndryshme për arsim).

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit**

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit parashihen në Nenin 3 të U.A nr. 151/2020, të datës 22/12/2020.

### **Kohëzgjatja:**

Periudha kohore e kontratës zgjatë 4 (katër) vjet.

**Data e njoftimit** në web-faqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej **dt. 14.01.2021** deri më **dt.12.02.2021**, ndërsa **koha e aplikimit** është nga **dt. 13.02.2021** deri më **dt. 28.02.2021**.

Përveç web-faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> po ashtu edhe në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës.

Fletaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Komunës po ashtu online në web-faqe.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë në ndërtesën e Komunës, rr. "Nuhi Gashi", Podujevë.

**Kujdes:** Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet- dokumentet e pa kompletuara nuk shqyrtohen-refuzohen.

Për të gjitha vendet e punës mbahen intervista, kurse orari i intervistimit shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të objektit të komunës dhe në webfaqe <http://kk.rks-gov.net/podujeve>.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të vazhdojnë procedurat vijuese.

Udhëzimi Administrativ i MASHT-it për detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, nr. 151/2020, të datës 22/12/2020,

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/12/ua-me-nr-151-1-per-detyrat-e-pergjegjsit-e-dr-dhe-zv-dre.pdf>

Avni Fetahu  
u.d. drejtor i DKA-së

